



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7 Mars 2023

Nr: 99

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË MALLAKASTËR,
PËR RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 7 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Armela Malaj person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Mallakastër

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mallakastër, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 65 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 28.1.2023 dhe datë 11.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 3 (tre) veprimtarive publike nga ana e bashkisë Mallakastër.

Data: 7 Mars 2023

Nr: 99
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mallakastër, për raportimin e veprimtarive publike”

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. Lidhur me indicien e parë: "Mallakastër - Vijon puna për rikonstruksionin e rrugës që lidh fshatin Mollaj me autostradën Levan-Tepelene. Premtim i mbajtur."

Prova link:

<https://www.facebook.com/100063697481485/videos/pcb.610613554405222/702507678038455>

2. Lidhur me indicien e dytë: "Mallakastër - Vijon puna për ndërtimin e linjës kryesore të furnizimit me ujë të pijshëm të qytetit të Ballshit dhe fshatrave përreth nga vendburimi i Poçemit deri në depon e Qafës së Kashit. Premtim i mbajtur".

Link i aktivitetit:

Prova link:

<https://www.facebook.com/100063697481485/videos/867944944320688>

3. Lidhur me indicien e tretë: "Përkujtuam sot 80-vjetorin e krijimit të Çetës Plakë të Mallakastrës në Klos. 04.02.1943, kjo datë historike, është një nga ngjarjet më të rëndësishme për Luftën Nacional Çlirimtare në Mallakastër e me gjerë".

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=558835549611891&set=pcb.558835742945205>

"Theksohet se këto aktivitete nuk janë raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve".

Neni 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi u shqyrtua paraprakisht çështja, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Megjithatë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 3 (tre) indicie nëpërmjet provave link të ndryshme, që i dejtohen të njëjtit subjekt, si dhe objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", vendos shqyrtimin së bashku të këtyre indicieve.

Me çeljen e hetimit administrative, fillimisht, më datë 13.2.2023 dhe në vijim më datë 16.2.2023, bashkisë Mallakastër i është kërkuar informacion në lidhje me indiciet e marra, nëpërmjet adresës elektronike.

Data: 7 Mars 2023

Nr: 99
Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mallakasër, për raportimin e veprimtarive publike"

Më datë 7.3.2023, bashkia Mallakastër, lidhur me indiciet e marra bën me dije se: *“Duke ju kërkuar ndjesë për tu njohur me emailt tuaja në kohe duke filluar nga pajisja me kredenciale për raportim dhe deri më tani po ju sqaroj si më poshtë vijon: Sot më është bërë e mundur rikthimi i email-it tim zyrtar pasi kam pasur probleme teknike në lidhje me aktivizimin e tij. Më datë 13.1.2023, jam pajisur me kredenciale nga ana juaj të cilat për arsytet e mësipërme nuk kam arritur ti marr. Më datë 18.1.2023, punonjësi i IT i bashkisë Mallakastër z. Hasan Likaj, i është drejtuar me email aktivitete@kqz.gov.al për mundësinë e krijimit të një llogarie në lidhje me raportimin e veprimtarive publike. Më datë 7.2.2023, (punonjësi i IT) ka nisur me email tek aktivitete@kqz.gov.al të gjitha datat e parashikuara me aktivitet që do të zhvilloheshin gjatë muajit Shkurt nga bashkia Mallakastër duke i sqaruar edhe mungesën e llogarisë. Ne vijim më datë 13.2.2023, me komunikimet telefonike që kemi pasur me KQZ është bërë e mundur pajisja me kredenciale e punonjësit të IT... Që nga ky moment kemi filluar të bëjmë raportimet të cilat ju i keni konstatuar jashtë afatit 5 ditor..., pra mungesa e raportimeve në kohë apo mosraportimi i disa prej tyre ka ardhur si pasojë e mospasjes së kredencialeve të derguara nga ana juaj.”*

Pas verifikimit të rrethanave dhe fakteve, vlerësoj se problematikat me sistemin dhe pajisjen me kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësoj se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të dokumentacionit të disponuar, provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit administrativ rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj bashkisë Mallakastër, nuk përbën shkelje të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

Data: 7 Mars 2023

Nr: 99
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mallakasër, për raportimin e veprimtarive publike”

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj zj. Armela Malaj person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Mallakastër.
2. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Mallakastër për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
3. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 7 Mars 2023

Nr: 99
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Mallakasër, për raportimin e veprimtarive publike”